

VENDIM
Nr. 134, datë 22.2.2017

PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK DHE PAKËSIMIN NË VOLUM TË SIPËRFAQES PREJ 1.18 HA NË NJËSINË ADMINISTRATIVE SURROJ, BASHKIA KUKËS, QË DO TË PËRDORET NGA SHOQËRIA “VLLAZNIMI DEDA IMPORT EKSPORT”, SH.P.K., PËR NDËRTIMIN E FABRIKËS SË PASURIMIT TË KROMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar dhe të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 10, të ligjit nr.9693, datë 19.3.2007, “Për fondin kullor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore publike prej 1.18 ha, që do të përdoret nga shoqëria “Vllaznimi Deda Import Eksport”, sh.p.k. për ndërtimin e fabrikës së pasurimit të kromit, në njësinë administrative Surroj, të hiqet nga fondi pyjor dhe kullor publik i Bashkisë Kukës, të pakësohet në volum dhe të çregjistrohet nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave. Lidhja 1, me të dhënat për sipërfaqen pyjore që pakësohet në volum dhe hiqet nga fondi pyjor e kullor publik, dhe harta topografike, me koordinatat e sipërfaqes objekt ndërtimi, i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Vlerat përkatëse të pakësimit në volum të lëndës drusore, produkteve të tjera pyjore dhe kullorë dhe të investimeve të kryera në vite, paguhen nga shoqëria “Vllaznimi Deda Import Eksport”, sh.p.k., në bazë të lidhjes 4, të vendimit nr.391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar dhe derdhen në llogarinë bankare të Bashkisë Kukës.

3. Shoqëria “Vllaznimi Deda Import Eksport”, sh.p.k., brenda 1 viti nga data e nënshkrimit të marrëveshjes me Bashkinë Kukës, të pyllëzojë me fondet e veta 1.18 ha me drurë pyjorë, sipas përcaktimeve në këtë marrëveshje.

4. Bashkia Kukës dhe shoqëria “Vllaznimi Deda Import Eksport”, sh.p.k. nënshkruajnë marrëveshjen e bashkëpunimit jo më vonë se 60 ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Një kopje e marrëveshjes, së bashku me projektet e miratuara, dërgohet për monitorim në Ministrinë e Mjedisit, jo më vonë se 10 ditë nga data e nënshkrimit të saj.

5. Sipërfaqja pyjore, sipas lidhjes 1, të këtij vendimi, mbetet pronë publike e shtetit dhe regjistrohet në përgjegjësi administrimi të Bashkisë Kukës.

6. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme bën çregjistrimin e sipërfaqes pyjore të identifikuar sipas lidhjes 1, të këtij vendimi, nga kategoria “Tokë e zënë pyjore” dhe e regjistron në kategorinë “Tokë e zënë, objekt i ndërtimit të fabrikës së pasurimit të kromit”.

7. Me përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në planin e rehabilitimit, sipas procedurës paraprake të vlerësimit të ndikimit në mjedis nga shoqëria “Vllaznimi Deda Import Eksport”, sh.p.k., sipërfaqja e rehabilituar të regjistrohet në fondin pyjor dhe kullor publik të Bashkisë Kukës.

8. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Bashkia Kukës dhe shoqëria “Vllaznimi Deda Import Eksport”, sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare


KRYEMINISTRI
Edi Rama

BASHKIA KUKËS

LISTA E NGASTRAVE DHE N/NGASTRAVE TË FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK QË HIQEN PËR NDËRTIMIN E FABRIKËS SË PASURIMIN TË KROMIT, SURROJ, KUKËS

Nr.	ID pones	Ekonomia pyjore/Kullosore	Ng/ n/ngast.	Përdorimi territorit	Sipërfaqja qe hiqet nga fondi pyjor/ kullosor ha
1	KU32 00 065 d	Mamez Kalimash	65 d	shkurre	1.18
	Gjithsej				1.18

HARTA TOPOGRAFIKE ME KONTURIN E SHESHIT TE FABRIKES SE PASURIMIT SURROJ SHKALLA 1 : 25 000



SUBJEKTI:
"VLLAZNIMI DEDA IMPORT- EXPORT" Sh.p.k

KOORDINATAT E SHESHIT TE FABRIKES

Nr. pikes	Y	X
1	44 45 716	46 55 972
2	44 45 755	46 55 990
3	44 45 789	46 55 952
4	44 45 830	46 55 927
5	44 45 853	46 55 869
6	44 45 793	46 55 847
7	44 45 743	46 55 839
8	44 45 748	46 55 891

KOORDINATAT E BURIMIT TE UJIT

Nr. pikes	Y	X
9	44 46 333	46 56 071

